



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0852
Data e Vendimit: 15.11.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit ekonomik (OE) NIKA PrO - Ing SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaqevë e epërme në Komunën e Kamenicës” me numër të prokurimit nuk ka-23-9841-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komp. Rajon Ujësjellësit Hidromorava SH.A., Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me 15/11/2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e palejuar, ankesa e OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K. me Nr. të protokollit 2023/0852, e datës 30/10/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaqevë e epërme në Komunën e Kamenicës”, me numër të prokurimit nuk ka-23-9841-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komp. Rajon Ujësjellësit Hidromorava SH.A

I lejohet, autoritetit kontraktues – Komp. Rajon Ujësjellësit "Hidromorava SH.A. që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaqevë e epërme në Komunën e Kamenicës”, me numër të prokurimit nuk ka-23-9841-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik e-prokurimi me datë 30/10/2023, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE "NIKA PrO- Ing" SH.P.K., për aktivitetin e prokurimit me “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaqevë e epërme në Komunën e Kamenicës” me numër të prokurimit nuk ka-23-9841-5-2-1, iniciuar nga Komp. Rajon Ujësjellësit Hidromorava SH.A., në cilësinë e autoritetit kontraktues.

Zyra e pranimit të ankesave pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi për ankesën në fjalë, nuk ka ofruar dëshminë e pagesës siç kërkohet me pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Nisur nga fakti se ankuesi ankesës së lartcekur, nuk i ka bashkangjitur konfirmimin e bankës për tarifën, zyra për pranimin e ankesave me datën 06.11.2023 përmes email-it e ka njoftuar OE ankues se ankesës së cekur si më lart nuk i ka bashkangjitur formularin për sigurim të depozitës të Ankesës, ta plotësoj ankesën sipas nenit 111 të LPP në të kundërtën hedhet si e palejuar ankesa. Por, edhe përkundër këtij njoftimi dhe sqarimi të OSHP-së deri me datën 13.11.2023 OE ankues nuk ka kompletuar ankesën sipas kërkesës së institucionit.

Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE "NIKA PrO- Ing "SH.P.K., e datës 30/10/2023 (protokoll 852/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull me “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaqevë e epërme në Komunën e Kamenicës” me numër të prokurimit nuk ka-23-9841-5-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komp. Rajon Ujësjellësit Hidromorava SH.A., konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në pikën 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.

Andaj procedura e shqyrtimit të kësaj ankese përfundon në këtë fazë duke e hedhur të njëjtën si e palejuar - jo e plotë ngase kjo ankesë nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet dispozitat ligjore të lartcekura.

Komp. Rajon Ujësjellësit "Hidromorava SH.A. mund që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaqevë e epërme në Komunën e Kamenicës” me numër të prokurimit nuk ka-23-9841-5-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit. Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se ky vendim ka karakter procedural kurse AK mban përgjegjësi për zhvillimin e më tutjeshëm të këtij aktiviteti, konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen me nenin 1, 6, 7,24.2 cituar: *"Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj"* lidhur me nenin 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, dhoma e shkallës së parë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Komp. Rajon Ujësjetësit "Hidromorava" SH.A.**
- **OE - NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- **Arkivës së OSHP-së:**